

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE
 MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGJIE
 MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
 SEKTORI I ARKIVES-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR

Njësia Org.
 Org. Jedinica
 Org. Unit
 Nr. i faqeve
 Br. stranica
 No. pages

Nr. Prot:
 Broj Prot:
 Prot. No:
 Data:
 Datum:
 Date:

1902-3
 22.10.2021

Original



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Datë: 1902-3
 Nr. 22-10-2021

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave të nenit 11 paragrafi 3 dhe 4, nenit 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 si dhe në bazë të neneve 5, 6, 7, 8 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, në bazë të kërkesës për rilicencim nga BPrAL- kolegji “ Pjetër Budi” nr. 1902 të datës 30.09.2021, nxjerr këtë :

V E N D I M

1. Bartësit Privat i Arsimit të Lartë (BPrAL)- kolegjit “Pjetër Budi”, në Prishtinë i refuzohet kërkesa për Licencim.
2. BPrAL – kolegjit “Pjetër Budi”, i lejohet t’i përcjell studentët e viteve paraprake për përfundimin e provimeve sipas vendimit ref. 423/18D i datës 18.05.2018 nga AKA konkretisht pika II dhe III, apo sipas nenit 12 pika 5 e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.
3. I ndalohet tërësisht transferi i studentëve sipas programeve apo viteve të studimit.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave të cekura më lartë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga kolegji “Pjetër Budi”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kushtet për licencim, sepse i njëjti institucion është licencuar për: “ ushtrimin e veprimtarisë aftësuese për nivelin II (dy),III(tre) dhe IV(katër) sipas KKK për programet ” sipas pikave 1.1; 1.2; 1.3.

Vendimi për licencimin e Kolegjit "Pjetër Budi" mban ref. nr. 3-598 i datës 13 prill 2021. Sipas këtij vendimi, në këtë institucion ushtrohet veprimtaria në përputhje me Certifikatën e lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, konkretisht Vendimi nr. 01-326 datë 31.05.2019.

Gjithashtu, BPrAL- kolegji "Pjetër Budi" përmes Letër konfirmimit nr. 83/2021 datë 04.03.2021 i drejtohet Ministrisë së Arsimit duke konfirmuar se ofron katin e II dhe III në shërbim të shkollës profesionale "Teknologji Informativ dhe Komunikim".

Komisioni për Licencimin e BPrAL-ve, duke pasur para vetes planin e evakuimit (B+P+2) mbi bazën e së cilës hapësirë (e vënë në dispozicion) është licencuar për arsimin e mesëm të lartë profesional kati I dhe II, nuk mund ta kuptoj se si dhe çfarë bazamenti hapësinor, i lihet në dispozicion pjesës së studentëve dhe mbajtjes së ligjëratave, ushtrimeve, konsultimeve dhe aktiviteteve të lira vepruese për ta!!!???

Kur këtyre fakteve i shtohet edhe çështja e mos aplikimit për licencim në kohën e paraparë e përforcon akoma më tepër mosdhënien e licencës nga ana e komisionit për Licencim i MASHTI-t.

BPrAL - kolegji "Pjetër Budi" për studentët e regjistruar sipas vendimit ref. 423/18D datë 18.05.2018 pika II që është i akredituar dhe pastaj edhe i licencuar nga MASHTI, i merr parasysh të dhënat e parashtruara në ato dokumente dhe ia lejon aktivitetin sipas asaj që është cekur në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi.

Kolegji " Pjetër Budi" nuk ka asnjë të drejtë të veprojë lidhur me transferin e studentëve për asnjë vit akademik apo program studimi nga marrja e këtij vendimi.

Komisioni duke marrë parasysh faktet e lartcekura, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, Sekretarit të përgjithshëm të MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Arkivit të MASHTI;
2. Parashtruesit të kërkesës;
3. Komisionit për licencim;
4. Sekretarit të përgjithshëm, MASHTI;
5. DALSH;
6. DNJBIA;
7. Inspektoratit, MASHTI.

Kryetar i Komisionit

Burim Gashi





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstvo Obrazovanja i
Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General
Secretary

Numër: 2-3006

Datë: 11.11.2021

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), nenit 135 paragrafi 2 i Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta zyrtare nr. 20 dt. 21 qershor 2016) dhe në bazë të nenit 11 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012, Licencimi i bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë, nxjerr:

V E N D I M

1. Kthehet në rishqyrtim lënda e kolegjit “Pjetër Budi”, ndaj vendimit me nr. 1902-3, datë: 22.10.2021, në Komisionin për shqyrtimin e lëndëve për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë.
2. Obligohet Komisioni për shqyrtimin e lëndëve për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë, të rishqyrtoj kërkesën e kolegjit “Pjetër Budi”.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Bazuar në dispozitat e cekura më lartë, kërkesën e kolegjit “Pjetër Budi”, rekomandimin me nr. 2-1K-2178 të dt. 04.11.2021 të Komisionit për ankesa dhe parashtrës, të cilët e kanë shqyrtuar lëndën dhe kanë konstatuar se lënda duhet të kthehet në Komisionin për shqyrtimin e lëndëve për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë, prandaj u vendos si dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Komisioni për shqyrtimin e lëndëve për LBPAL;
2. Kolegjit “Pjetër Budi”
3. Zyrës së SP/MASHTI;
4. Arkivit/MASHTI.

Fadile Dyla

Zv. sekretare e përgjithshme/MASHTI



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE, TEHNOLOGIJE I INOVACIJE
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION
SEKTORI I ARKIVIT - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE RECTOR

Njësa Org.
Org. Jedinica
Org. Unit
Nr. i fletëve
Str. strahiloj
No pages

Prishtinë / 2

Mr. Prati
Nr. i fletëve
Org. Unit
Nr. i fletëve
Str. strahiloj
No pages

2080
30.11.2021



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Datë: 2080
Nr. 30-11-2021

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave të nenit 11 paragrafi 3 dhe 4, nenit 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 si dhe në bazë të neneve 5, 6, 7, 8 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, si dhe në bazë të vendimit nr.2-3006 i datës 11.11.2021 i nxjerrë nga zv. sekretari i MASHTI për Rishqyrtim të lëndës së BPrAL- kolegji “Pjetër Budi” nxjerr këtë :

V E N D I M

1. Bartësit Privat i Arsimit të Lartë (BPrAL)- kolegjit “Pjetër Budi”, në Prishtinë, i refuzohet kërkesa për Licencim.
2. I ndalohet regjistrimi i studentëve sipas programeve apo viteve të studimit.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave të cekura më lartë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të vendimit të parashtruar nga zv. sekretarja e MASHTI, lidhur me RISHQYRTIMIN e lëndës së kolegjit “Pjetër Budi”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kushtet për licencim, sepse i njëjti institucion për të njëjtin objekt/hapësirë është licencuar për “Ushtrimin e veprimtarisë aftësuese për nivelin II (dy), III(tre) dhe IV(katër) sipas KKK për programet” sipas pikave 1.1; 1.2; 1.3.

Vendimi për licencimin e kolegjit “Pjetër Budi “ mban ref. nr. 3-598 i datës 13 prill 2021. Sipas këtij vendimi, në këtë institucion ushtrohet veprimtaria në përputhje me Certifikatën e lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, konkretisht Vendimi nr. 01-326 datë 31.05.2019.

Gjithashtu, BPrAL- kolegji "Pjetër Budi" përmes Letërkonfirmimit nr. 83/2021 datë 04.03.2021 i drejtohet Ministrisë së Arsimit duke konfirmuar se ofron katin e II dhe III në shërbim të shkollës profesionale "Teknologji Informativ dhe Komunikim".

Komisioni për Licencimin e BPrAL-ve, duke pasur para vetes planin e evakuimit (B+P+2) mbi bazën e së cilës hapësirë (e vënë në dispozicion) është licencuar për arsimin e mesëm të lartë profesional kati I dhe II, konstaton se nuk ka hapësirë të mjaftueshme që i mbetet në dispozicion për veprimtarinë e arsimit të lartë, si pjesën e studentëve për mbajtje të ligjëratave, ushtrimeve, konsultimeve dhe aktiviteteve të lira vepruese për ta.

Përveç tjerash, komisioni rithekson se kolegji nuk ka respektuar afatin për të bërë kërkesën me kohë për licencim për vitin 2021/2022.

Kolegji "Pjetër Budi" nuk ka asnjë të drejtë të veprave lidhur me regjistrimin, transferin e studentëve për asnjë vit akademik apo program studimi nga marrja e këtij vendimi.

Komisioni duke marrë parasysh faktet e lartcekura, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, Sekretarit të përgjithshëm të MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Arkivit të MASHTI;
2. Parashtruesit të kërkesës;
3. Komisionit për licencim;
4. Sekretarit të përgjithshëm, MASHTI;
5. DALSH;
6. DNJBIA;
7. Inspektoratit, MASHTI.

Kryetar i Komisionit

Burim Gashi

Pnshunëja

